

VENDIM
Nr. 13, datë 15.1.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 262, DATË 2.12.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SLR ALBANIA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme me nr. 36/1 prot., datë 14.1.2026, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘SLR Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike’ i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 262, datë 2.12.2024, ka licencuar shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 mw.

- Në kuptim të pikës 2, të vendimit të nr. 262/2024, përcaktohet se: Përpara fillimit të operimit, shoqëria “SLR Albania” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në paraprake të re. Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 294, datë 26.12.2024, pika 2 e vendimit të lartpërmendur është shfuqizuar.

- Referuar pikës të 3, të vendimit nr. 262/2024, shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.

- Gjithashtu, në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi në zbatim të plotësimit të pikave 2 dhe 3”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE, me shkresën nr. 2536 prot., datë 29.9.2025, ka kërkuar informacion ndaj shoqërisë, lidhur me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.

- Në përgjigje të kësaj shkrese, shoqëria “SLR Albania” sh.p.k., me shkresën e datës 9.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2536/1 prot., datë 14.10.2025, ka bërë me dije se: “Shoqëria ‘SLR Albania’ sh.p.k. është pajisur me lejen e ndërtimit nr. 505/10, datë 8.9.2025, miratuar me vendimin nr. 45, datë 24.12.2024 të KKT-së. Sipas pikës 2, të nenit 9, të kontratës së nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të vendosë në punë objektin, brenda 12 muajve nga pajisja me lejet dhe në këto kushte është brenda afatit të përcaktuar në kontratë”. Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se sipas njoftimit të punimeve të datës 10.9.2025, puna ka filluar më datë 15.9.2025.

- Referuar afateve të përcaktuara në vendim, vërehet se, bazuar në kontratën e nënshkruar mes shoqërisë “SLR Albania” sh.p.k. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 114 rep., nr. 73 kol., datë 31.1.2024, “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘SLR Albania’ sh.p.k.”, Mbajtësi i miratimit për ndërtim merr përsipër të vërë në punë centralin fotovoltaike, brenda 12 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikonin e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur kontratës. Afati

për pajisjen me lejet e nevojshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore, është jo më shumë se 9 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

- Në vijim, me shkresat nr. 1 dhe 2 prot., datë 6.1.2026, protokolluar në ERE me nr. 36 prot., dhe nr. 40 prot., datë 7.1.2026, shoqëria “SLR Albania” sh.p.k. ka paraqitur raportimin e saj mujor dhe vjetor mbi sasinë e energjisë elektrike të prodhuar, ku rezulton se centrali ka hyrë në prodhim gjatë muajit dhjetor 2025, duke gjeneruar sasinë prej 115850 kwh ose 115.85 mwh.

- Deklarimi i bërë nga shoqëria “SLR Albania” sh.p.k. rezulton në përputhje edhe me raportimin paraprak të shoqërisë “OSSH” sh.a. mbi prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, të lidhura në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në kushtet kur subjekti njofton se është pajisur me leje ndërtimi më datë 10.9.2025 dhe afati i kësaj leje është për një periudhë 12-mujore, si dhe rezulton se ka filluar ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike në muajin dhjetor 2025, atëherë vlerësohet se pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, i ndryshuar, duhet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e pikës 3 të këtij vendimi, lind nevoja për shfuqizimin edhe të pikës 4 të tij, pasi kushtet e vendosura në pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 262/2024, të ndryshuar, janë plotësuar.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësohet që duhet të shfuqizohen pikat 3 dhe 4, të vendimit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 3 dhe 4, të vendimit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, të ndryshuar, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti